

REPUBLIKA E KOSOVËS

NË EMËR TË POPULLIT

P. nr.446/17

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICËS-departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i etëm gjykues Gezim Ademi, dhe procesmbajtësja Hasnije Muhaxheri, ne lenden penale ndaj te pandehurit K.H. me vendbanim ne Rr. “...” - lagjja ... ne ... për shkak te veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 ne lidhur me par 2. 1 pika1.1 te KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës te Prokurorisë Themelore ne Mitrovice- PP.II.nr.486/2017 te datës 07.07.2017 pas mbajtjes se shqyrtimit fillestar te dt. 22.01.2018, ne mungese te PTH. Natasha Radoviq e ne prezence te te pandehurit e ne te njëjtën dite publikisht shpall ketë, ndërsa me dt. 25.01.2019 përpiloi ketë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: K.H., nga i ati ..., e ëma ..., e vajzërisë ..., i lindur me ..., me vendbanim ne ... rr. “...”-Lagjja ..., me nr. Personal ..., i pa pune, ka te kryer shkollën e mesme ekonomike, i martuar baba i tre fëmijëve, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me 26.06.2017 rreth orës 16:45 min., ne ... ne rrugën “...”, saktësisht ne shtëpinë e përbashkët familjare, i ka shkaktuar lëndim trupor personit tjetër dhe atë bashkëshortes se tij- te dëmtuarës A.H., ashtu qe pas mosmarrëveshjeve te vazhdueshme ne mes tyre, e dëmtuara po fliste ne telefon me nënën e saj, e i pandehuri e thërret qe ajo ti ndihmon diçka rreth automjetit, ku vonohet për një çast, dhe kur e dëmtuara ofrohet, atëherë i pandehuri ne shenje revolte e godet me grusht pse je vonuar, dhe ia kërkon çelësat e automjetit, ku e dëmtuara i përgjigjet se “duhesh te me kërkosh falje për sjelljet e tua ndaj meje”, atëherë i pandehuri ia merre telefonin dhe ia then xhamin e telefonit, pastaj merr gjygymin e çajit dhe e godet ne koke te dëmtuarën, te cilët fillon ti rrjedh gjak nga koka, dhe e dëmtuar kërcen nga dritarja, del ne rrugë, shoh një patroll te policisë te cilët e dërgojnë te mjeku, me c’ rast e dëmtuara ka pësuar lëndime te lehta trupore-ndrydhje e indeve te buta ne regjionin e kokës, plage shqyese ndrydhëse ne regjionin e kokës, me pasoja te përkohshme për shëndetin.

Me këtë ka kryer veprën penale- **Lëndimi i lehte trupor nga neni 188 par.3 lidhur me par.2 e 1 pika 1.1 te KPRK-se.**

Andaj gjykata ne mbështetje te nenit 4,7,17,21,41,49,50,51,52,73, dhe 188 par.3 lidhur me par.2 e 1 pika 1.1 te KPRK-ës dhe nenit 365, 450,463 te KPP-ës i:

G J Y K O N

ME DENIM BURGU NE KOHEZGJATJEJE PREJ 1 (një) viti, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale ne kohëzgjatjeje prej 2 (dy) vite.

OBLIGOHET i pandehuri qe ne emër te shpenzimeve procedurale- ekspertizën mjeko-ligjore shumen prej 20.00€, për paushallin gjyqësor te paguaj shumen prej 30 Euro, ndërsa për fondin e kompensimit te viktimave te krimit shumen prej 30 euro, te gjitha këto është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike-kompensimin e demit udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë - ka ngritur aktakuze PP.II.nr. 486/2017 te datës 07.07.2017, kundër të pandehurit K.H. nga ..., për shkak te veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 ne lidhur me par 2. 1 pika1.1 te KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt. 22.01.2019 ashtu qe ne këtë seance i pandehuri lidhur me fajësinë ka deklaruar: e pranoj fajësinë, me vjen keq për rastin qe ka ndodhur, dhe i tregon gjykatës se ne jetojmë se bashku me bashkëshorten time - dëmtuarën dhe ne tash kemi raporte te mira, këtë e bëjë me vullnet dhe pa presionin e askujt.

Lidhur me pranimin e fajësisë prokurori i ka propozuar gjykatës që të pranohet fajësia e te pandehurit nga se pranimi i fajësisë nga i njëjti ishte pa presion pa dhune me vullnet dhe i propozon gjykatës qe pranimin e fajësisë te këtë parasysh si rrethane lehtësues dhe faktin qe te njëjtit janë pajtuar nuk kane me probleme, jetojnë se bashku.

Lidhur me pranimin e fajësisë e dëmtuara deklaron: e pranoj pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, ne jetojmë se bashku dhe kemi krijuar raporte te mira dhe i propozon gjykatës qe te shqiptoj ne dënim sa me te lehte.

I. Vlerësimi i pranimin te fajësisë.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte ne përputhje me neni 248 pasi qe i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë i pandehuri e bene ne mënyrë vullnetare, pas sqarimeve te mjaftueshme nga ana e gjykatës, se aktakuza nuk përmban shkelje te qarte ligjore apo gabime faktike qe do te bënin te pamundur qe gjykata te beje vlerësimin e pranimin te fajësisë, se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është i mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban akuza, te gjitha këto për gjykatën përveç se vërtetojnë faktet e çështjes se akuzës njëkohësisht janë ne përputhje me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e te pandehurit, këto rrethana vërtetohen nga provat qe gjenden ne shkresat e lendes si: Raporti policor 2017-BC-585, Deklarata e te dëmtuarës dt.26.06.2017, Dosja kriminale ne emër te te pandehurit, Ekspertiza mjeko Ligjore dt.04.07.2017, si dhe foto dokumentacionin, nga te gjitha këto si dhe nga pranimi i fajësisë nga ana e te pandehurit vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale: Lëndimi i lehte trupor nga neni 188 par.3 lidhur me par.2 e 1 pika 1.1 te KPRK-se.

II. Vlerësimi lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se kjo veprë penale është e dënueshme me dënim me burgim prej tre (3) muaj deri ne tre (3) vjet, andaj duke vlerësuar

rrethanat lehtësuese dhe renduese, kjo gjykate si rrethana renduese ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale rrethanat ne te cilat ishte kryer vepra penale.

Si rrethane lehtësuese gjykata ka gjetur rrethanat personale te kryerësit dhe sjelljen e tij pas kryerjes se veprës penale, gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë e qe nga deklarimi i tij me rastin e pranimit te fajësisë i njëjti deklaroi se e ndien veten fajtor ky deklarim i tille i te pandehurit për gjykatën shpreh një pendim te thelle te tij për veprën penale, si rrethane tjetër lehtësuese ka gjetur se te njëjtit kane tre fëmijë dhe jetojnë se bashku e kane raporte te mira bashkëshortorë.

Nga te gjitha këto gjykata duke vlerësuar te gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurit pasi qe për gjykatën ne rrethana te tilla mjafton se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimeve, do te ndaloj kryerësin qe te mos kryej vepra penale ne te ardhmen e qe ky është edhe qëllimi i dënimit me kusht. Nga te gjitha këto rrethana kjo gjykate vlerëson se edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurit.

III. Lidhur me shpenzimet e procedurës penale.

Lidhur me shpenzimet procedurale- ekspertizën mjeko-ligjore shumen prej 20.00€, për paushallin gjyqësor te paguaj shumen prej 30 Euro, ndërsa për fondin e kompensimit te viktimave te krimit shumen prej 30 euro, te gjitha këto është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

IV. Lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata te dëmtuarit i ka udhëzuar ne konteste te rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 248, 365, 450, te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P. nr.446/2018 dt.25.01.2019

Procesmbajtësja :
Hasnije Muhaxheri

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gëzim Ademi

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kane te drejte ne ankese ne afat prej 15 ditëve ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, nëpërmes kësaj gjykate